



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 233, Datë 05.11.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SH.A. NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1315/8 prot., datë 04.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1315/2 prot., datë 27.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka një licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të vlefshme deri më 20.12.2024. Duke qenë se nuk aplikoi brenda datës 20.06.2024 për rinovimin e licencës, referuar nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, ku përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Subjekti “AXPO ALBANIA” sh.a., ka depozituar në ERE një aplikim të ri. Për sa më sipër afatet e kësaj licence do të fillojnë nga data 21.12.2024.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 214, datë 14.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2024 dhe 16.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të

tretët (data 28.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 1315/5 prot., datë 18.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në vijim, me shkresat nr. 1315/6 prot., datë 23.10.2024 dhe nr. 1315/7 prot., datë 31.10.2024 shoqëria ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “AXPO ALBANIA” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 21.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “AXPO ALBANIA” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**